

VENDIM
Nr.405, datë 25.6.2004

PËR PAGËN MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të nenit 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për përcaktimin e pagave të punës” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 10 800 (dhjetë mijë e tetëqind) lekë.

2. Paga bazë minimale mujore të jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 62,07 lekë.

3. Shtesat me karakter të përhershëm të jepen mbi pagën bazë.

4. Vendimi nr.588, datë 28.8.2003 i Këshillit të Ministrave “Për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano